



E – PROKURIMI

Regjistrimi

OPERATORËT EKONOMIK

Janar 2016

1 Regjistrimi

Për të përdorur sistemin e prokurimit elektronik, duhet të regjistroheni dhe të pajiseni me një llogari përdoruesi. Kjo mund të realizohet duke u regjistruar online si operator ekonomik.

Regjistrohuni me zgjedhjen e menysë “Regjistrimi” dhe pastaj plotësoni format e të dhënave dhe informatat e organizatës dhe të përdoruesit. Gjatë regjistrimit do të njoftoheni me “Kushtet e përgjithshme” me të cilat duhet të dakordoheni në nënyrë që të përfundoni procedurën e regjistrimit me sukses. Pasi të shtypni butonin “Ruaj” në formën e fundit, kontrolloni e-mailin me të cilin jeni regjistruar, ku do të pranoni njoftimin për regjistrim të suksesshëm dhe linkun për aktivizim të përdoruesit.

Pas aktivizimit të suksesshëm të përdoruesit do të keni qasje në sistemin elektronik të prokurimit publik.

2 Regjistrimi i operatorit ekonomik

2.1 Operatorët ekonomik

Në sistemin elektronik të prokurimit publik rolet e përdoruesve janë të paracaktuara. Varësisht nga roli janë të caktuara të drejtat dhe mundësitë. Brenda një organizate është e mundur të regjistrohen më shumë se një përdorues.

Pas regjistrimit përdoruesi e merr rolin "Admin OE" i cili ka mundësi të krijojë përdorues të ri brenda organizatës dhe u cakton rolin përkatës – që mund të jetë rol për shkarkim të dokumenteve.

2.2 Funkcionalitetet të cilat janë në dispozicion pas regjistrimit të përdoruesit:

Administratori i operatorit ekonomik: përdorimi i kërkimit të avancuar, përditësimi i shënimeve për organizatën, përdorimi i kriterëve të kërkimit (filtrat), pranimi i e-mailit sipas kriterëve të kërkimit, krijimi i përdoruesit të ri brenda organizatës, pranimi i dokumentacionit, shtëpiza personale, shtëpiza e përbash në nivel të organizatës (njoftimet nga të gjithë përdotuesit brenda organizatës).

Operatorët ekonomikë: me përdorimin e kërkimit të më parshëm ,me përdorimin e kriterëve të kërkimit (filterit), pranimi i dokumentacionit , shtëpiza personale .


Pranimi i dokumentacionit : pranimi i dokumentacionit , shtëpiza personale, numër i pakufizuar i përdoruesëve brenda organizatës .

Gjithë ashtu edhe shërbimet me funksionalitete të avansuar:

- përkujtues
- e - mail e rekapitular
- publikimet interesante

Për tu regjistruar si operator ekonomik në sistemin e prokurimit publik duhet të ndiqni këta hapa:


Hapni faqen e prokurimit elektronik e-prokurimi.rks-gov.net, shkoni tek menyja Regjistrimi dhe zgjedhni Operator ekonomik (Personi juridik).



Figurë 1. Operatorët ekonomikë

2.3 Kodi sigurisë

Përdoruesi në hapin e dytë duhet të plotësojë kodin e sigurisë që sistemi të dijë se regjistrimin në sistem e kryen personi e jo makina ose mjete.



Figurë 2. Regjistrim i kodit të sigurisë

Butoni anash përdoret për refresh të kodit dhe pastaj sistemi gjeneron kod të ri. Në rast të pritjes më të gjatë, kodi do të skadojë dhe kur të provoni të kaloni në hapin e dytë do të merrni paralajmërimin se kodi i sigurisë ka skaduar. Pastaj e përdorë butonin refresh që të merrë nga sistemi kod të ri dhe përsëri shkruan dhe pastaj klikon ruaj /vazhdo.



Figurë 3. Paralajmërim për vlefshmëri dhe mbarimin e kodit

2.4 Informatat për subjektin ekonomik

Në hapin e dytë e regjistroni emrin e organizatës dmth. subjektin ekonomik. Vlera e parazgjedhur e shtetit është Kosova, por duke klikuar në loockup e hap formën e re me regjistrin e shteteve ku zgjedh ate që dëshiron . Operatorët ekonomik me biznes të regjistruar në Kosovë duhet të shënojmë vetëm numrin fiskal, dhe të dhënat e tyre kryesore do të plotësohen automatikisht nga ATK. Operatorët ekonomik të jashtëm duhet t'i plotësojnë vetë të gjitha shënimet.

2. OE - informatat e përdoruesit

Operatorët ekonomik me biznes të regjistruar në Kosovë duhet të shënojmë vetëm numrin fiskal, dhe të dhënat e tyre kryesore do të plotësohen automatikisht nga ATK. Operatorët ekonomik të jashtëm duhet t'i plotësojnë vetë të gjitha shënimet.

Plotësoni me të dhënat nga Administrata Tatimore e Kosovës duke u bazuar në numrin fiskal

Numri fiskal

Organizata/Emri (Company/Name)*

Shtet 🔍 ✕

Numri fiskal*

Numri i regjistrimit të biznesit (vetëm për OE nga Kosova)

Figurë 4. Vendosja e shënimeve themelore të subjektit ekonomik

2.5 Adresa e operatorit ekonomik

Për regjistrimin e adresës së re zgjedhet alternativa „I ri“ dhe regjistro shënimet e detyrueshme:

- Tipi i adresës ,
- Adresa,
- Numri postal ,
- Vendi;

Shënimet jo të detyrueshme:

- Telefoni,
- Telefaksi,
- E-mail,
- Vërejtje.

Është e detyrueshme dhe e nevojshme të regjistrohet adresa e selisë dhe adresa e llogarisë, pavarësisht se a janë adresat e njëjta. Nëse dëshironi t'i modifikoni shënimet e regjistruara apo të fshini ndonjë adresë, është e nevojshme të shënohet adresa e dëshiruar , dhe pastaj e zgjedhni alternativën „Ndrysho/refuzo“.

Figurë 5. Regjistrimi i adresës

Pas regjistrimit të adresës sistemi iu transferon në pjesën ku i regjistroni shënimet e përdoruesit. Forma e përdorimit është identike me formën ["Regjistrimi i operatorët ekonomikë \(personi fizik\)"](#) dhe mundet të shikohet në këtë artikuj të udhëzimeve të përdoruesit.

3 Regjistrimi i operatorit ekonomik - personi fizik

Procedura e regjistrimit fillon me klikim në „REGJISTRIMI“ në faqen e-Prokurimi.

Përdoruesi e zgjedh regjistrimin e personit fizik.

Figurë 6. Regjistrimi i personit fizik

3.1 Kodi i sigurisë

Përdoruesi në hapin e dytë duhet të plotësojë kodin e sigurisë që sistemi të dijë se regjistrimin në sistem e kryen personi e jo makina ose mjeti.

1. Kodi i sigurisë

⚠️ Kjo pyetje shërben për të bllokuar reklamat që mund të na vijnë nga robotë kompjuterik. Jeni të lutur të vendosni në kutinë bosh, kodin që shihni në imazhin e shfaqur më poshtë.

GTHGJ

GTHGJ

Vazhdo

Figurë 7. Regjistrimi kodit i sigurisë

Butoni anash përdoret për refresh të kodit dhe pastaj sistemi gjeneron kod të ri. Në rast të pritjes më të gjatë, kodi do të skadojë dhe kur të provoni të kaloni në hapin e dytë do të merrni paralajmërimin se kodi i sigurisë ka skaduar. Pastaj e përdorë butonin refresh që të merrë nga sistemi kod të ri dhe përsëri shkruan dhe pastaj klikon ruaj /vazhdo.

1. Kodi i sigurisë

⚠️ Kjo pyetje shërben për të bllokuar reklamat që mund të na vijnë nga robotë kompjuterik. Jeni të lutur të vendosni në kutinë bosh, kodin që shihni në imazhin e shfaqur më poshtë.

LQLC6

GTHGJ

Vazhdo

Paralajmërim!

Kodin i vendosur ka skaduar pas sekondash

Figurë 8. Paralajmërim për vlefshmërin dhe mbarimin e kodit

3.2 Shënimet themelore për përdoruesin

Në hapat vijues regjistrohen shënimet e përdoruesit, në të vërtet pranuesit të dokumentacionit për konkurrim. Shënimet e detyrueshme janë ato të shenuara me shenjën (*).

2. Informata për përdoruesin

Emri:*

Mbiemri:*

Numrin e identifikimit:

Adresa*

Telefoni*

Faksi*

Paraparak Ruaj dhe vazhdo

Figurë 9. Shënimet e informacionit themelor të përdoruesit

3.3 Përzgjedhja e gjuhës

Përdoruesi e zgjedh gjuhën e cila në të ardhmen do të jetë gjuha kryesore/default. Pavarësisht nga kjo përdoruesi mund të ndryshoj gjuhën përmes formës edhe pas përfundimit të regjistrimit.

Regjistruhu ofertuesin - Anëtar

1. Kodi i sigurisë ✓
2. Informata për përdoruesin ✓
3. **Gjuha Default** ✓
4. E-mail ✓
5. Pyetja sekrete (dhe përgjigjja) ✓
6. Informatat për regjistrim ✓
7. Termat dhe kushtet e përgjithshme ✓
8. Informatat për regjistrim - Përmbledhje ✓

3. Përzgjedh gjuhën e default

Gjuhë parazgjedhje

English
Shqip
Srpski

Paraparak zhdo

Figurë 10. Zgjedhje gjuhës

3.4 E - mail i përdoruesit

Gjithashtu, si shënim i detyrueshëm është e-mail adresa e përdoruesit , që sistemi të ketë mundësi të dërgon njoftime me e-mail, siç janë:

- E-maili për aktivizimin e llogarisë së përdoruesit
- Shënimet shtesë për procedurën për të cilën e keni marrë dokumentacionin për konkurim.
- Ju duhet të konfirmojë adresën e-mail!

3. E-mail

Email*

Email konfirmuar*

Pas përfundimit të procesit të regjistrimit, në email-in e specifikuar do të dërgohet udhëzimi i aktivizimit të llogarisë së shfrytëzuesit.

Paraparak Ruaj dhe vazhdo

Figurë 11. Shënimi i e-mailit të përdoruesit

3.5 Pyetja sekrete /përgjegjja në pyetjen sekrete

Plotësoni fushat me pyetjet sekrete dhe përgjigjen në pyetjen sekrete e cila shërben me rast të humbjes të fjalëkalimit.

Figurë 12. Pyetja sekrete

3.6 Emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi

Emri i Përdoruesit - vetë e përcaktoni (p.sh. mbiemër, emëri.mbiemër etj.).

Fjalëkalimin - gjithashtu vetë e përcaktoni.

Kushtet për dhënjen e sakët të fjalëkalimit:

- Gjatesia minimale 8 simbole
- Duhet të përmban më së paku 1 shifër
- Nuk duhet të filloj me emrin e përdoruesit
- **Karakteret që nuk janë të lejuara: <> \ / " : * ? |**

Figurë 13. Emri përdoruesit dhe fjalëkalimi


3.7 Kushtet e përgjithshme

Para përfundimit të procedurës së regjistrimit përdoruesi patjetër duhet të pranojë kushtet e përgjithshme të afarizmit, të cilat mund të shikohen me klikim në „Kushtet e përgjithshme të afarizmit“, të cilat i përcakton KRPP.

Figurë 14. Pranimi i kushteve të përgjithshme

3.8 E-mail aktivizues

Me klikim në butonin “RUAJ” shënimet për regjistrim i dërgohen automatikisht me e-mail shërbimit për përdorues dhe vetë përdoruesit. Në e-mailin të cilin e pranoni gjendet linku për aktivizim. Duke klikuar atë përdoruesi ka aktivizuar llogarinë me të drejtat e përdoruesit.



The screenshot shows an email from e-prokurimi@rks-gov.net with the subject "Llogaria aktivizimi i përdoruesit / User account activation / Aktivacija korisničkog računa". The recipient is Emri Mbiemri. The email body contains instructions in Albanian and English to activate the user account. It includes a link to activate the account and provides contact information for the Help Desk Service (PPRC) in Albanian and English. The email also mentions that the user can find a copy of the message in their inbox after logging in.

E martë: 26.12.2016 12:34
e-prokurimi@rks-gov.net
Llogaria aktivizimi i përdoruesit / User account activation / Aktivacija korisničkog računa

Për: Emri Mbiemri

I/e nderuar/a Emri Mbiemri

Ne kemi pranuar kërkesën tuaj për regjistrim në sistemin elektronik të prokurimit publik të Kosovës. Për të konfirmuar e-mail adresën tuaj dhe për të aktivizuar llogarinë tuaj, ju lutemi klikoni [këtu](#).

Nëse linku "Këtu" nuk funksionon, ju lutemi kopjoni adresën në vijim në browser-in tuaj: http://mswin12/SPIN_KOSOVO/application/ipn/Admin/RegistrationConfirmFrm.aspx?quid=9f2a598d-2b45-413f-b1ee-b19c42e70ae3

Ju mund të gjeni një kopje të këtij njoftimi në sistemin elektronik të prokurimit të Kosovës. Pas kësaj në sistemin, në menyne MESAZHET zgjedhni Mesazhet e mia. Nëse keni pyetje shtesë, ju lutemi kontaktoni shërbimin Help Desk.

Gjithë të mirat,
KRPP
Help Desk Service
telefon: (06) yyy-xyx
e-mail: PPRC-HD@rks-gov.net
working hours: working days from 8h till 16h

Dear Name Surname

We received your registration request for Electronic public procurement system of Kosovo. To confirm your e-mail address and activate user account, please click [here](#)

If link "here" does not work, please copy following address into Internet browser: http://mswin12/SPIN_KOSOVO/application/ipn/Admin/RegistrationConfirmFrm.aspx?quid=9f2a598d-2b45-413f-b1ee-b19c42e70ae3

You can find copy of this message in Electronic public procurement system of Kosovo. After log-in, in menu MY NOTIFICATIONS select My Inbox. If you have any additional questions, please contact Help Desk Service.

Best regards,
PPRC
Help Desk Service
telefon: (06) yyy-xyx
e-mail: PPRC-HD@rks-gov.net
working hours: working days from 8h till 16h

Poštovani(a) Ime Prezime

Primiti smo Vaš zahtev za registraciju na Sistem elektronske javne nabavke Kosova. Da biste potvrdili svoju e-mail adresu i aktivirali korisnički račun kliknite [ovde](#)

Ako vam link "ovde" ne funkcioniše, molimo da iskopirate sjedeći tekst u internetski preglednik: http://mswin12/SPIN_KOSOVO/application/ipn/Admin/RegistrationConfirmFrm.aspx?quid=9f2a598d-2b45-413f-b1ee-b19c42e70ae3

Kopiju ove poruke možete da pronadete u sistemu elektronske javne nabavke Kosova. Nakon prijave, u izborniku MOJA POŠTA odaberite Moje poruke. Imate li dodatnih pitanja, obratite se Službi za korisnike.

Srdačan pozdrav,
PPRC
Služba za korisnike
telefon: (06) yyy-xyx
e-mail: PPRC-HD@rks-gov.net
radno vreme: radnim danom od 8h do 16h

Figurë 15. Aktivizimi e-mail